



Udhëzues për Studentat

Google Classroom ju lejon të ngarkoni detyrat tuaja, të forconi bashkëpunimin dhe të lehtësoni komunikimin, për ta bërë mësimin më produktiv dhe të vlefshëm. Pedagogët mund të krijojnë klasa, të caktojnë detyra, të dërgojnë *feedback* dhe të mbajnë gjithçka nën kontroll, në një aplikacion të vetëm. Classroom përshtatet gjithashtu pa probleme me produktet e tjera të Google, të tilla si Google Docs dhe Drive.

Kushte paraprake


Për të përdorur Classroom është e mjaftueshme të keni një lidhje interneti dhe të zgjidhni një nga *browser*-at e pranishëm në PC (psh. Chrome, Firefox, Internet Explorer ose Safari, në përgjithësi përshtatet me versionet kryesore të *browser*-ave më të përdorshëm).

Për të përdorur Google Meet për mësimdhënien në distancë, do t'ju duhet gjithashtu një videokamer dhe mikrofon, ose një kompjuter laptop me kamera dhe mikrofon të integruar.

Kredencialet

Të gjithë studentëve u është dërguar një e-mail njoftues nga ced@unizkm.al me kredencialet e tyre, një prezantim i shkurtër dhe disa *link*-e për përdorimin e Google Classroom.

Ata që nuk e kanë marrë këtë e-mail, ose kanë probleme të ndryshme për të hyrë në llogarinë e tyre, duhet të shkruajnë në ced+password@unizkm.al ku të shënojnë Emrin, Mbiemrin dhe Programin e Studimit.



Si të hyri në Google Classroom

Për të hyrë në Google Classroom, së pari duhet të futeni në postën <https://mail.google.com/a/unizkm.al>, duke u identifikuar me kredencialet institucionale @stud.unizkm.al (e.mbiemër <numrin e matrikullës @stud.unizkm.al, xYzAbcdeF). Më pas duhet të klikoni në menunë me ikonën katrore (ikonën me kuadrate në pjesën e sipërme-djathtas) dhe të lëvizni nëpër ikonat e pranishme derisa të gjeni dhe përzgjidhni Classroom (shikoni figurën 1).

Gjithashtu mund të futeni në aplikacionin Classroom direkt nga linku <https://classroom.google.com/> pasi të keni hyrë me kredencialet tuaja të postës elektronike.


Si të përdorni aplikacionin Android

- Për të shkarkuar aplikacionin Classroom, klikoni në [Shkarko ap Classroom](#).
- Klikoni tek Hap.
- Klikoni tek Fillo.
- Klikoni tek Shto llogari ► OK.



- Vendosni e-mail-in tuaj dhe klikoni Përpara.
- Vendosni password-in dhe klikoni Përpara.
- Nëse shfaqet një mesazh për mirëserardhjen, lexojeni dhe klikoni Pranoj.
- Lexoni Kushtet e Shërbimit dhe Rregullat e Privatësisë dhe klikoni Pranoj.
- Nëse përdorni një llogari G Suite for Education, klikoni në Jam student.

Si të regjistroheni në një lëndë si student




Si të regjistroheni në një lëndë me kodin e lëndës



Në rast se pedagogu /koordinatori/sekretaria ju ka dërguar Kodin e një lënde që jeni të interesuar të ndiqni (rregullisht ose rekuperim) (Kodi i një lënde përbëhet nga gjashtë ose

shtatë gërma ose numra. Për shembull, hjhmgrk ose g5gdp1):

Nëpërmjet kompjuterit: Në pjesën e sipërme të ekranit, klikoni Shto ► Regjistrohu tek lënda, Vendosni kodin dhe klikoni Regjistrohu.



Nëpërmjet Celularit: Në pjesën e sipërme të ekranit, klikoni Shto ► Regjistrohu tek lënda. Vendosni kodin e lëndës që keni marrë nga pedagogu juaj dhe klikoni Regjistro.





Si të pranoni një ftesë nga pedagogu juaj

Nëse pedagogu/koordinatori/sekretaria ju ka shtuar direkt në lëndë (për të gjithë studentët e vitit në vijim), në faqen tuaj në kryesore të Classroom, ju do të shihni Ikonën e lëndës me butonin "Regjistrohu" për të pranuar


ftesën.



Ap Celular: Në kartelën e lëndës, klikoni tek Regjistrohu.



Si të anuloni regjistrimin nga një lëndë




Nëse anuloni regjistrimin nga një lëndë, nuk do ta shihni më në Classroom, por të gjithë dokumentet shoqëruese do të arkivohen në Google Drive-in tuaj. Nëse anuloni regjistrimin nga një lëndë gabimisht dhe doni të regjistroheni sërish, lexoni Si të regjistrohemi në një lëndë si student. Nëse nuk e keni kodin, i kërkoni pedagogut / koordinatorit që t'ju ftojë përsëri.

- Klikoni në Menu ► Lëndët.
- Tek lënda, klikoni tek Tjetër ► Anullo regjistrimin.
- Për të konfirmuar, klikoni tek Anullo regjistrimin.

Tabela ime e informacionit mbi Classroom

Të gjitha lëndët në të cilat jeni regjistruar mund të shihen në faqen kryesore:



Nëse klikoni tek një lëndë, do të keni mundësi të shihni materialet e lëndës, detyrat, studentët e tjerë si dhe pedagogun. Gjithçka është e organizuar në grupe në tre menutë që mund të shikoni (Stream, Classwork, People).


Stream Classwork People






Në menunë "Stream" mund të shikoni të gjitha materialet që ka vendosur pedagogu për lëndën, njoftimet për detyrat.


Në menunë "Classwork" mund të shikoni të gjitha detyrat dhe materialin e lëndës që pedagogu ka vënë në dispozicion. Mund të shikoni detyrat e caktuara (p.sh. detyra-kursi). Mund të shikoni informacionin e lëndës në faqen Stream. Nëse pedagogu ka shtuar informacione, mund të jenë të pranishme tema e lëndës, përshkrimi etj.




Si të shihni kalendarin e leksioneve

Do të keni mundësi të shikoni eventet e programuara, për shembull orët e leksioneve. Në listën e Kalendarë të tjerë, ju mund të gjeni të gjitha kalendarët e kursit dhe të specifikoni nëse doni t'i shfaqni ose t'i fshihni.

Klikoni tek lënda > Detyrat e lëndës. > Klikoni në Google Calendar .



(Opsionale) Për më shumë detaje klikoni tek një element. (Opsionale) Për të shfaqur ose fshehur kalendarët e tjerë të lëndës, në të majtë, tek Kalendarët e tjerë, kontrolloni kutinë përkatëse për një lëndë.



Si të merrni pjesë në një leksion online

Për të marrë pjesë në një leksion online mund të lidheni:

- Nga e-maili i ftesës, duke klikuar te "Merr pjesë në Hangouts Meet"
- Ose, nëse nuk e keni marrë e-mailin, nga Google Classroom -> Lënda -> Detyra -> Kalendar, gjithmonë duke klikuar tek eventin dhe tek linkun "Merr

pjesë në Hangouts Meet".

Apeli Virtual për praninë në Classroom

Në 20 minutat e para të leksionit, do të shihni një pyetje për apelin virtual, në faqen Classwork. Jeni të lutur të përgjigjeni me "I pranishëm".



Kini kujdes! Pyetja çaktivizohet automatikisht pas 20 minutave të para.



Appello lezione 03/04/2020

Scadenza: 13:00



appello test

Scadenza: 11:57

Data pubblicazione: 11:55

Consegnato in ritardo



Presente

1

Non Presente

0

[Visualizza domanda](#)

Qendra e Suportit:

<https://support.google.com/edu/classroom/?hl=it&authuser=0#topic=9049835>

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni:

Zyra Informatikës

Email: ced@unizkm.al

Tel: 00355 4 2273290

Adresa: Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"